



Prishtinë: 19.11.2021
Kodi i ZRRE-së: V_1453_2021

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2254_10_21** të dt. 25.10.2021;
- Ankesën e konsumatorit të dt. 02.11.2021;

në seancën e mbajtur më datë 19.11.2021 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar ankesa e konsumatorit M.Sh nga Komuna e Besianës.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK_V_2254_10_21, i datës 25.10.2021.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtje të Konsumatorëve në ZRrE me datë 25.10.2021 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK_V_2254_10_21, me të cilin e ka refuzuar ankesën e konsumatorit M.SH nga Komuna e Besianës, lidhur me kontestimin e faturës së energjisë elektrike të dt. 28.05.2020 si dhe korrigjimin shtesë të dt. 23.06.2020.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatori M.SH, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRrE-së për këto shkaqe:

- Vërtetim i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike;
- Punëtorët e KEDS-it nuk e kanë dërguar njehsorin elektrik për ta bërë kontrollimin teknik, për të konstatuar mangësitë e tij;
- Konsumatori kërkon nga Bordi i ZRRE-së që të anulohë vendimin e DMK-së dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 19.11.2021 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pretendimin e konsumatorit se vendimi është i mbështetur në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, ZRrE thekson se, janë analizuar me kujdes të gjitha shkresat e lëndës dhe pas administrimit të provave veç e veç, si: Procesverbalin mbi pranimin e instalimit të njehsorit elektrik, të



dt. 01.02.2020; Faturën e dt. 01.02.2020; Ankesën e konsumatorit të dt. 29.05.2020; Përgjigjen e KESCO-s të dt. 23.06.2020; Ankesën e konsumatorit në DMK të ZRrE-së, dt. 03.07.2020; Rrjedhën e energjisë elektrike dhe listat e leximit; Korrigjimin plotësues të dt. 23.06.2020. Pas analizimit të të gjitha provave materiale, Bordi i ZRrE-së ka konstatuar se konsumatori nga periudha 02/2020 e deri në periudhën 04/2020 është faturuar pa matje/në mënyrë të vlerësuar, kurse në periudhën 05/2020 është faturuar me 9.660 kWh. Po ashtu, sipas listave të leximit, është vërtetuar se, lexuesi i KEDS-it nga periudha 02/2020 deri në periudhën 05/2020 nuk ka pasur qasje në leximin e shpenzimeve mujore. Departamenti për Mbrojtje të Konsumatorëve, si shkallë e parë në ZRrE, ka analizuar shpenzimet për periudhën 02/2021 dhe 05/2021 dhe ka gjetur se, totali i shpenzimeve për këtë periudhë është 9,661 kWh e që kjo përputhet me shpenzimin e faturuar në periudhën 05/2020. Për më tepër, ZRrE ka gjetur se, shpenzimi i faturuar për periudhën 05/2020 nuk mund të paraqet shpenzim real mujor të konsumatorit, përkatësisht paraqet grumbullim të kilovatëve, e një gjë e tillë është në kundërshtim me nenin 28, par. 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, në të cilën parashihet si vijon: *“1. Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar r dhe për tarifat tjera, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme) dhe 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit universal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit”*.

Pra, ZRrE ka gjetur se, konsumatorit M.SH, nuk i takon korrigjimi financiar dhe si kilovatët e faturuar në periudhën 05/2020 duhet të shpërndahen, ashtu që, është obliguar KESCO që t'i ofroj konsumatorit një kontratë pagese prej 4 muajve, respektivisht nga data 02/2020 – 05/2020.

Ndërkaq, korrigjimi plotësues i bërë nga Departamenti i Faturimit në KESCO i dt. 23.06.2020 në vlerë prej 67.39 EUR është në harmoni me nenin 28 par.3 i Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike, në të cilën thuhet se: *“Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, e të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do t'i bëjë të gjitha korrigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese”*. Andaj, pretendimin e konsumatorit se kemi të bëjmë me vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, e vlerësojmë si të pa qëndrueshëm dhe aspak relevant, sepse, nga sa u tha më sipër, ZRrE ka administruar të gjitha shkresat e lëndës, dhe ka gjetur se, ankesa e konsumatorit është e pa bazuar.

Duke u bazuar në nenin 5, par. 1.5 i Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, *“Të gjithë konsumatorët janë të obliguar që të paguajnë për energjinë e shfrytëzuar, sipas kontratës për furnizim me energji të lidhur me Furnizuesin e Energjisë, si dhe për tarifat për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRRE-ja”*, Bordi ka konstatuar se ankesa e konsumatorit duhet të refuzohet.

Andaj, në harmoni me nenin 48 të Ligjit nr.05/L-031 të Procedurës së Përgjithshme Administrative, Bordi i ZRrE-së i ka vlerësuar të gjitha pretendimet e ankuesit dhe i ka analizuar të gjitha dëshmitë dhe provat që lidhen më rastin në fjalë dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë



dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 19.11.2021 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO-së,
- Konsumatorit M.SH,
- Arkivit të ZRRE-së.